



**Instituti i Kosovës për Drejtësi**

# **Llogaridhënia e sistemit të drejtësisë:**

**Raport mbi rregullimin e llogaridhënies së  
sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë**

Prishtinë, mars 2014

Autorët: Adem Gashi dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD  
9-A, 5  
Rr. Rexhep Luci  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[ëëë.kli-ks.org](http://ëëë.kli-ks.org)

përkrahur nga:

Mars 2014  
Prishtinë, Republika e Kosovës

**PËRMBAJTJA:**

I.	Përmbledhja ekzekutive.....	4
a.	Besueshmëria e qytetarëve në sistemin e drejtësisë .....	5
III.	Llogaridhënia institucionale në raport me pushtet tjera .....	7
a.	Presidenca vs. Gjyqësori dhe Prokuroria .....	7
b.	Kuvendi vs. Gjyqësori dhe prokuroria .....	9
c.	Gjyqësori vs. Qeveria .....	12
IV.	Llogaridhënia e brendshme e gjyqësorit.....	14
a.	Shkallshmëria e sistemit .....	14
b.	Kodet e Etikës dhe të Sjelljes .....	15
c.	Angazhimi jashtë-gjyqësor i gjykatësve dhe prokurorëve .....	15
d.	Paraqitja e pasurisë dhe të ardhurave.....	19
e.	Zyra e Prokurorit Disiplinor.....	20
i.	Emërimi i drejtorit.....	22
ii.	Buxhetimi .....	22
f.	Komisionet disiplinore .....	23
g.	Përbërja e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial .....	24
V.	Rekomandimet:.....	26

## I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

### II. HYRJA

Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë është element mjaftë i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë.<sup>1</sup> Për të ndërtuar besueshmëri patjetër se duhet siguruar transparencë dhe llogaridhënie të sistemit të drejtësisë. Në këtë mënyrë pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarëve të garantuara me Kushtetutë do të pasqyrohen edhe në punën e tyre të përditshme në sigurimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Një gjë e tillë arrihet vetëm përmes profesionalizimit dhe integritetit të gjyqtarëve në ndarje të drejtësisë dhe të prokurorëve në zhvillim të hetimeve dhe luftim të krimeve.

Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në gjyqësor është një indikatorë i mirë i çmuar për të vlerësuar se si funksionon sundimi i ligjit në vend.<sup>2</sup> E njëjta vlen edhe për sistemin prokurorial.

Neni 10 i Deklaratës së Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut thekson:

*“Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.”<sup>3</sup>*

Ndërsa, Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike i Asamblesë së Përgjithshme thekson:

*“Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile.”<sup>4</sup>*

Parimet Themelore për pavarësi të gjyqësorit theksojnë qartë se Pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet me Kushtetutë dhe ligje të vendeve, se gjyqësori duhet të jetë i paanshëm në vendosjen e rasteve duke evituar ndikimet jo adekuate, presionet apo ndërhyrjet tjera, se gjyqësori do të ketë juridiksion mbi të gjitha çështjet që janë të natyrës gjyqësore dhe do të ketë autoritet ekskluziv për të vendosur në qoftë se rastet e caktuara janë brenda kompetencave të

<sup>1</sup> Opinioni numër 3 i Këshillit Konsultativ për Gjykatësit Evropian (KKGJE) për vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që qeverisin sjelljen profesionale të gjykatësve, në veçanti etika, sjelljet dhe paanshmëria që nuk është në pajtim

<sup>2</sup> *Etika gjyqësore: Zhvillimet, sfidat dhe zgjidhjet. Eksperienca e Moldavisë në forcimin e Standardeve të Etikës për Gjykatësit* (Këshilli i Evropës: Rrjeti i Lisbonës).

<sup>3</sup> *Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut, neni 10*, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 10 dhjetor 1948.

<sup>4</sup> Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 14. Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, u miratua me 16 dhjetor 1966 dhe hyri në fuqi me 23 mars 1976.

tyre, dhe se nuk duhet të ketë ndërhyrje jo-adekuate apo jo të arsyeshme në procese gjyqësore apo të rishikohen vendimet e gjykatave përveç në rastet e rishikimeve gjyqësore apo proceseve të faljeve/lirimeve/amnitive që bëhen sipas ligjit.<sup>5</sup>

Po ashtu, dokument tjetër i rëndësishëm është edhe Parimet e Bangalorit për Sjellje në Gjyqësor të cilat ndër tjera udhëzojnë gjykatësit rreth sjelljeve të tyre.<sup>6</sup> Është tejet e rëndësishme të theksohet se Parimet e Bangalorit përbëhen nga gjashtë vlera: pavarësia, paanshmëria, integriti, drejtësia, kompetenca dhe dinjiteti. Rrjedhimisht, vetëm një sistem gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm do të jetë shtyllë për ndërtimin e legjitimitetit për demokracinë në vend.<sup>7</sup>

Të gjitha këto vlera dhe parime vlejné edhe për prokurorët, të cilët patjetër se duhet të udhëhiqen nga puna profesionale dhe integriteti. Në mënyrë që të sigurohet një funksionim i tillë i sistemit të drejtësisë, është tejet e rëndësishme që të mbrohet pavarësia e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe njëkohësisht të instalohen mekanizma efikas të llogaridhënies, ashtu që gjyqtarët dhe prokurorët të jetësojnë parimet më të larta të interpretimit të ligjit.

### a. Besueshmëria e qytetarëve në sistemin e drejtësisë

Etika dhe sjelljet e gjykatësve dhe prokurorëve janë tejet të rëndësishme që të sigurohet besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Në Kosovë, niveli i besueshmërisë së qytetarëve në sistemin e drejtësisë në Kosovë është tejet i ultë. Ky indikatorë kaq i rëndësishëm është injoruar në masë të madhe nga institucionet e drejtësisë si një parametër i llogaridhënies. Duke u bazuar në hulumtime të ndryshme, kryesisht të organizatave ndërkombëtare, ndër tjera kemi këto përfundime sa i përket sistemit të drejtësisë:

- *Pulsi Publik i UNDP-së* i publikuar në gusht 2013 paraqet se vetëm 16.7%-17.7% e respondentëve kanë theksuar se kanë besim në gjykata dhe prokurori<sup>8</sup>
- *“Të bërit biznes 2014”* i Bankës Botërore rendit Kosovën në vendin e 138 sa i përket zbatimit të kontratave<sup>9</sup>
- Sipas *Transparency International* hulumtimi i opinionit publik ka nxjerrë në pah se gjyqësori konsiderohet tejet i ndikuar nga korrupsioni, ku i është vënë nota 4.1 (5 është perceptimi i korruptuar në ekstrem)<sup>10</sup>

<sup>5</sup> *Parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit, kapitulli Pavarësia e gjyqësorit, nenet 1-4*, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, miratuar me 29 nëntor 1985 dhe 13 dhjetor 1985.

<sup>6</sup> Parimet e Bangalorit për Sjellje në Gjyqësor, Grupi për Integritet në Gjyqësor, ku këto parime janë miratuar me rezolutën e Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara me rekomandim të Komisionit për Parandalim të Krimit dhe Drejtësi Penale të Kombeve të Bashkuara në vitin 2006.

<sup>7</sup> Një opinion i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian thekson se vendet e Evropës Lindore të cilat kanë kaluar nga regjimet autoritare e kanë parë ligjin dhe drejtësinë si shtylla të cilat do të prodhojnë legjitimitet për të ndërtuar demokracinë. Opinioni numër 3 i Këshillit Konsultativ për Gjyqtarët Evropian (KKGJE) për vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që qeverisin sjelljen profesionale të gjykatësve, në veçanti etika, sjelljet dhe paanshmëria që nuk është në pajtim.

<sup>8</sup> *Pulsi Publik 6* (Prishtinë: UNDP Kosovë, gusht 2013), f. 10.

<sup>9</sup> *Doing Business, The World Bank*, shih <http://ëëë.doingbusiness.org/data/exploreconomies/kosovo/>.

Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies në gjyqësor ka bërë që besimi i palëve në gjykatat të cilat ndajnë drejtësinë të jetë e vogël. Madje, niveli i besueshmërisë as në prokurori nuk qëndron më mirë. Kjo për shkakun për një numër të madh të çështjeve vlejnë vetëm ligjet e xhunglës dhe ka mungesë të reagimit të prokurorëve për të zgjidhur këto raste, sidomos në rastet ku palë janë njerëz me ndikim.

BIRN në raportin vjetor për monitorim të gjykatave të vitit 2012 ndër tjera thekson se ka mungesë koordinimi gjatë caktimit të seancave gjyqësore, përfaqësimi jo i mirëfilltë i shtetit nga prokurorët, shkelje procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor, mungesa e përkthimit në seancat gjyqësore, pasaktësitë në procesverbale, ambientet jo adekuate për mbajtje të seancave gjyqësore, mos respektimi i orarit të seancave gjyqësore, mungesa e përdorimit të pajisjeve elektronike në gjykata, dhe përdorimi i telefonave mobil gjatë seancës, si dhe mungesa e uniformave gjyqësore.<sup>11</sup> Këto mangësi të proceseve gjyqësore gjithsesi se ndikojnë në krijimin e perceptimit negativ, humbjen e besimit, dhe mungesën e respektit për institucionet e drejtësisë.

Sistemi gjyqësor dhe prokurorial nuk bënë hulumtim të opinionit publik për nivelin e besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë. Në anën tjetër, institucionet e drejtësisë sikurse edhe ato qeveritare në vazhdimësi vendosin në pikëpyetje saktësinë e hulumtimeve të zhvilluara nga të tjerët. Hulumtim profesional dhe i detajuar i opinionit publik sa i përket performancës së sistemit të drejtësisë është një nevojë tepër e madhe dhe urgjente.

---

<sup>10</sup> *Transparency International*, shih [http://ëëë.transparency.org/country#KOS\\_PublicOpinion](http://ëëë.transparency.org/country#KOS_PublicOpinion).

<sup>11</sup> Ky raport është bazuar në 1,441 pyetësorë të plotësuar gjatë vitit 2012, ku janë monitoruar 1,040 seanca të mbajtura ndërsa 401 seanca kanë dështuar. Nimoni G., *Raporti vjetor i monitorimit të gjykatave 2012* (Prishtinë: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese BIRN Kosovë, janar 2013).

### III. LLOGARIDHËNIA INSTITUCIONALE NË RAPORT ME PUSHTET TJERA

Hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka shënuar progresin më të madh sa i përket pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë. Parimi i ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancit në mes tyre në Republikën e Kosovës garantohet me aktin më të lartë juridik të vendit.<sup>12</sup> Krahas pavarësisë natyrshëm duhet të vij edhe llogaridhënia e secilit pushtet. Të sistemuar në kuadër të Kapitullit të Sistemit të Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial gëzojnë pavarësi tepër të madhe karshi pushteteve tjera. Krahas sigurimit të pavarësisë së këtyre dy Këshillave, politikëbërësit dhe ekspertët kanë vendosur që llogaridhënia për sistemin gjyqësor dhe prokurorial të sigurohet ekskluzivisht nga mekanizmat e brendshëm. Llogaridhënia e sistemit gjyqësor dhe prokurorial ndaj pushteteve tjera ekziston në aspektin formal dhe atë në nivel minimal. Në këtë drejtim rrugët për të mbajtur llogaridhënës bartësit e funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale, përkatësisht sistemin gjyqësor dhe prokurorial është lënë përmes emërimeve të gjykatësve dhe prokurorëve te Presidenti<sup>13</sup> i Republikës si dhe raportimi vjetor në Kuvendin<sup>14</sup> e Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës ka një histori të shkurtër të ndërtimit të institucioneve të drejtësisë me legjislacion, i cili synon të plotësojë kriteret e Bashkimit Evropian, por ende nuk e ka të ndërtuar kulturën e llogaridhënies. Përderisa në Kosovë mungon kultura e llogaridhënies, shtrohet nevoja që të përcaktohen norma ligjore për të siguruar llogaridhënien, dhe me evoluimin e kohës të synohet ndërtimi i kulturës së llogaridhënies.

#### a. Presidenca vs. Gjyqësori dhe Prokuroria

Aspekti i llogaridhënies së sistemit gjyqësor dhe prokurorial, i cili paraqitet në frymën e Kushtetutës, përmes emërimit dhe shkarkimit të gjykatësve dhe prokurorëve nga Presidenti i Republikës është tejet i kufizuar, sidomos pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese<sup>15</sup> lidhur me amandamentet e propozuara për procesin e ndryshimit të Kushtetutës.

Presidenti i Republikës tash për tash emëron dhe shkarkon gjykatësit dhe prokurorët, pas propozimeve të KGJK-së apo KPK-së. Ndërsa, në rastet kur Presidenti refuzon të emërojë apo

<sup>12</sup> Neni 4, “Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit”. Kapitulli I-rë, Dispozitat Themeleore. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008.

<sup>13</sup> Neni 84, Kompetencat e Presidentit, Kapitulli V-të, Presidenti i Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008.

<sup>14</sup> Neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] “8. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku një herë në vit lidhur me Sistemin Gjyqësor”. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008. Si dhe Neni 4, “Detyrat, Kompetencat dhe Kufizimet e Këshillit”, “1.11. raportimi tek Kuvendi i Kosovës, Presidenti dhe publiku mbi punën e Këshillit dhe të Prokurorisë së Shtetit”; Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës. 29 tetor 2010.

<sup>15</sup> Aktgjykim në Rastet K.O.29/12 dhe K.O.48/12. Amandamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit t 137 Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012. Nr. Ref. AGJ 284/12. Gjykata Kushtetuese. 20 korrik 2012.

riemërojë cilindo kandidat për gjykatës apo prokuror, Presidenti detyrohet brenda afatit gjashtëdhjetë (60) ditor t'i siguroj arsyet e refuzimit të tij ndaj KGJK-së, përkatësisht KPK-së. Të dy Këshillat, mund të paraqesin edhe një herë tjetër kandidatin e refuzuar para Presidentit së bashku me arsyetimin, ose mund të propozojnë një kandidat tjetër.

Refuzimi i kandidatëve për emërim nga ana e Presidentit duhet të bëhet me arsyetim të fuqishëm, pas të cilit arsyetim, KGJK apo KPK, do të bindeshin për lëshimin e bërë për emërim në rastin e propozimit të kandidatëve. Nëse refuzimi i Presidentit nuk ka bazë dhe arsyeshmëri të mjaftueshme për mos emërim të kandidatëve të propozuar, të njëjtin Presidenti **detyrohet ta emëroj**, pasi Këshillat kanë të drejtë t'ia propozojnë sërish kandidatët e njëjtë. Kjo situatë është sqaruar mjaftë mirë në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte vendosur rreth amandamenteve të propozuara kushtetuese për Presidentin. Gjykata Kushtetuese ka vendosur vijën e kuqe për Presidentin, i cili duhet të emërojë propozimet e Këshillave.

Komentari Ligjor<sup>16</sup> të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pjesën e kompetencave të Presidentit, theksohet se koncepti i “emërimit” dhe “shkarkimit” siç përcaktohet tek këto kompetenca, nuk duhet të komentohet si kompetencë e pavarur e Presidentit, por “komentimi logjik i këtyre dy koncepteve kushtetuese, të ndërlidhura me funksion kushtetutes të KGJK-së si sigures/garantues i meritës së profesionit të gjyqtarëve, nënkupton që kompetenca e presidentit për “emërim” dhe “shkarkim” duhet të komentohet thjeshtë në aspektin ceremonial. Sipas këtij komentari, rezulton se presidenti nuk mund të kontrolloj meritën e propozimeve që vijnë nga Këshilli Gjyqësor dhe rrjedhimisht nuk mund të ushtrojë kontroll substancial mbi këto propozime. Madje, komentari thekson se “Presidenti është thjeshtë i “detyruar që t'i konfirmojë propozimet e tilla”. Mundësia e vetme që presidenti të ketë thënie në këtë proces të emërimeve apo shkarkimeve nga ana e Këshillit ka të bëjë me aspektin e rregullësisë procedurale, por jo në aspektin substancial.

Por, para shpjegimit të kësaj shtate, duhet të analizohet praktika e emërimit dhe riemërimit të gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë, e cila dha shembullin e ndërhyrjeve politike në procesin e emërimit të bartësve të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë.<sup>17</sup> Gjatë procesit më të rëndësishëm të reformës kadrovike në sistemin e drejtësisë në Kosovës, përkatësisht procesit të riemërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve, ish-Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, kishte larguar nga lista e kandidatëve për tu emëruar tre kandidatë për gjykatës dhe prokuror. Në asnjë rast, u.d. i Presidentit nuk kishte dhënë shpjegime as në KGJK e as në publik se pse kishte refuzuar emërimin e tyre.<sup>18</sup> Refuzimi për t'i emëruar dhe mosarsyetimi ndaj KGJK-së padyshim

<sup>16</sup> Hasani E. dhe Çukallovic I., *Komentar Ligjor: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Botimi I* (Prishtinë: GIZ, dhjetor 2013), f. 406.

<sup>17</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për 2010 për Kosovën. Komisioni Evropian. (shikuar për herë të fundit me 4 nëntor 2013

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf) )

<sup>18</sup> “Procesi i riemërimit dhe emërimit, pavarësia dhe ndikimet: Riemërimi dhe emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë”. Musliu B. Gusht 2011.



se vulosi vlerësimin se kishte të bënte me ndërhyrje politike gjë e cila u theksua në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian.

Këshilltari juridik i Presidentes aktuale të Republikës thekson se përkundër aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila kompetencën e emërimit të gjykatësve e ka kategorizuar te kompetencat e kufizuara, Presidentja pas propozimeve nga KGJK dhe KPK e ka kompetencën e vendosjes për emërim ose shkarkim si filtër i fundit i emërimit ose shkarkimit.<sup>19</sup>

IKD vlerëson aspektet teorike të ekspertëve të pavarur, por mbështet interpretimin e dhënë nga Gjykata Kushtetuese në aktgjykim dhe interpretimin në komentarin ligjor të Kushtetutës, i cili kufizon Presidentin në procesin e emërimeve dhe shkarkimeve, duke vlerësuar ndërhyrjen e tij vetëm në anën procedurale por jo edhe substanciale të propozimeve të Këshillave. KGJK dhe KPK në bazë të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial, raportojnë te Presidenti mbi punën e Këshillave, të Gjyqësorit dhe Prokurorit të Shtetit në përgjithësi, por ky raportim nuk ndërlidhet me aspektin përmbajtjesor të llogaridhënies, por ka vetëm karakter informativ.<sup>20</sup>

Aspekt tjetër i ngritur rreth llogaridhënies së KGJK-së dhe KPK-së në raport me Presidentin, mbetet Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit. Ky Këshill është një institucion i cili ndihmon në koordinimin dhe bashkëveprimin e institucioneve të ndryshme që ndjekin korrupsionin në Kosovë. Mënyra e raportimit të institucioneve pjesëmarrëse në Këshill paraqet një lloj mekanizmi të llogaridhënies në fushën e performancës dhe arritjeve në fushën e tyre. Përmes këtij raportimi identifikohen nyjet e bashkëpunimit të cilat atëherë sanohen me inpute të të gjitha institucioneve.<sup>21</sup> Ndryshe, adreson përgjegjësinë e këtij Këshilli, Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, i cili thekson se “Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit u krijua me qëllimin për të siguruar përgjegjësi dhe llogaridhënie të institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit”.<sup>22</sup> Pavarësisht interpretimeve të ndryshme për mandatin e këtij Këshilli, ky mekanizëm në praktikë vlerësohet si mekanizëm senzibilizues dhe ka efekt psikologjik për krerët e KGJK-së dhe KPK-së, por assesi llogaridhënës ndaj Presidentes dhe Këshillit.<sup>23</sup>

## **b. Kuvendi vs. Gjyqësori dhe prokuroria**

Kuvendi i Republikës së Kosovës në kuadër të kompetencave të veta poashtu nuk ka mandat që të mbajë llogaridhënës pushtetin gjyqësor dhe prokurorial. Kuvendi “mbikëqyr punën e Qeverisë

<sup>19</sup> Intervistë me z. Selim Selimi, Këshilltar Juridik i Presidentes së Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga.

<sup>20</sup> Intervista me z. Enver Peci, Kryesues i KGJK-së dhe me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit dhe Kryetar i KPK-së. Nëntor 2013.

<sup>21</sup> Intervistë me z. Selim Selimi, Këshilltar Juridik i Presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga. Nëntor 2013.

<sup>22</sup> Dokument Pune i Personelit të Komisionit. Raporti i Progresit 2013 për Kosovën. Bruksel. 16 tetor 2013.

<sup>23</sup> Intervista me z. Enver Peci, Kryesues i KGJK-së dhe me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit dhe Kryetar i KPK-së. Nëntor 2013.

dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit”.<sup>24</sup> Megjithatë, KGJK dhe KPK njëjtë sikurse te Presidenti raportojnë edhe në Kuvend mbi punën e KPK-së dhe KGJK-së, por as ky raportim nuk ndërlidhet me aspektin përmbajtësor të llogaridhënies, por ka vetëm karakter informativ.<sup>25</sup> Detyrimi ligjor ka të bëjë vetëm me informim të Kuvendit, por në asnjë mënyrë KGJK<sup>26</sup> e as KPK nuk kanë detyrim të raportojnë ose të merren në përgjegjësi nga Kuvendi për gjendjen në sistemin gjyqësor apo sistemin prokurorial.

Disa prej anëtarëve të Komisionit për Legjislacion në Kuvend, vlerësojnë se raportimi në Kuvend i KGJK-së dhe KPK-së mund të ketë efekte, por meqenëse Kuvendi nuk ka fuqi që të kërkoj sanksione për performancën e gjykatësve dhe prokurorëve, pra jo me vendim apo përmes rezolutës, por vetëm deklarativisht dhe kjo nuk ndihmon shumë.<sup>27</sup> Kuvendi ka dështuar në krijimin e mekanizmave për forcimin e raportimit në Kuvend. Shembull konkret në rastet e shqyrtimit të raporteve në Kuvend, edhe po që se nuk kalon raporti nuk ka ndonjë dispozitë ligjore se çka ndodh më pas. Natyrisht në shtete me përvojë në llogaridhënie, raportimi në Kuvend do të mjaftonte sepse do të ishte shqetësim me të cilin do të merreshin institucionet përgjegjëse, në rastin e Kosovës, KGJK dhe KPK.<sup>28</sup>

As emërimi nga Kuvendi i shumicës së gjykatësve si anëtarë të KGJK-së<sup>29</sup> nuk hyn në sferën e llogaridhënies së KGJK-së ndaj Kuvendit, sepse këta anëtarë i japin llogari vetëm Këshillit dhe aspak Kuvendit. Madje, përzgjedhja e anëtarëve të KGJK-së, të cilët zgjedhën nga Kuvendi bëhet pa një bazë të mirëfilltë procedurale, pasi mungon një rregullore për një gjë të tillë. Kjo ka ndikuar që gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të KGJK-së nga Kuvendi shpesh të haset në probleme dhe mungesa e kësaj rregulloreje është e qëllimshme, sepse përzgjedhja bëhet pa kritere, duke iu lënë subjekteve politike dhe akterëve tjerë të shtyjnë përpara njerëzit e tyre.<sup>30</sup> Gjithashtu mungesa e rregullores vështirëson edhe llogaridhënien e anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi meqë të njejtit në këto rrethana do të jenë llogaridhënës vetëm ndaj atyre që ua kanë siguruar votat por edhe do t'i përfaqësojnë interesat e tyre e assesit të qytetarëve.<sup>31</sup> Raportimi i këtyre anëtarëve të KGJK-së të zgjedhur nga Kuvendi mund të kërkohej në Komision dhe në Kuvend,

<sup>24</sup> Neni 65, Kompetenca e Kuvendit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008.

<sup>25</sup> Intervista me z. Enver Peci, Kryesues i KGJK-së dhe me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit dhe Kryetar i KPK-së. Nëntor 2013.

<sup>26</sup> Hasani E. dhe Çukallovic I., *Komentari Ligjor: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Botimi I* (Prishtinë: GIZ, dhjetor 2013), f. 518.

<sup>27</sup> Intervistë me z. Behar Selimi, anëtar i Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës. Nëntor 2013.

<sup>28</sup> Intervistë me z. Behar Selimi, anëtar i Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës. Nëntor 2013.

<sup>29</sup> Shënim: Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka 13 anëtarë. Pesë (5) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit; Katër (4) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve. Të paktën dy (2) nga katër (4) anëtarët duhet të jenë gjyqtarë, dhe një (1) do të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës; (3) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar; (4) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara

ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;

<sup>30</sup> Intervistë me znj. Albulena Haxhiu, anëtar i Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës. Nëntor 2013.

<sup>31</sup> Intervistë me znj. Albulena Haxhiu, anëtar i Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës. Nëntor 2013.

por në fund kjo nuk prodhon asnjë efekt llogaridhënës.<sup>32</sup> Prandaj, deri në përfundim të mandatit nuk mund askush t'iu bëjë asgjë anëtarëve të cilët janë zgjedhur nga Kuvendi në KGJK. Përprjekja për shkarkim të këtyre anëtarëve nuk ndalohet, por akoma nuk ka pasur praktikë të këtillë dhe nuk është e rregulluar me norma juridike prandaj çdo përprjekje në këtë drejtim do të vlerësohej si politike.<sup>33</sup>

Kryesuesi i KGJK-së në vitin 2013 ka raportuar në Komisionin për Legjislacion në Kuvend, pas ftesës së këtij komisioni.<sup>34</sup> Paraqitja e Kryesuesit të KGJK-së para anëtarëve të këtij Komisioni është bërë për hir të respektit por jo se pse KGJK-ja ka detyrim kushtetues apo ligjor për t'iu përgjigjur këtij Komisioni. Asnjë nga anëtarët së bashku me Kryetarin e Komisionit për Legjislacion nuk kanë qenë në gjendje të sqarojnë dilemën nëse ftesa për të raportuar Kryesuesi i KGJK-së në këtë Komision është e drejtë dhe kushtetuese apo këtë të drejtë e ka vetëm Kuvendi i Kosovës.<sup>35</sup>

Çështja e llogaridhënies së organeve të drejtësisë kundrejt Kuvendit është shfaqur haptas në disa raste, kur deputetët kanë kërkuar këso llogaridhënie. Në nëntor 2013, Komisioni për Punë të Jashtme kishte ngritur çështjen e llogaridhënies së EULEX duke pretenduar se ky mision është duke dështuar që të vendosë drejtësi në kohë të arsyeshme, duke marrë këtu rastet kur personat mbahen në paraburgim për një kohë të gjatë.<sup>36</sup> Në vitin 2013, në Kuvendin e Kosovës u hap debat për një rast gjyqësor për të cilin tashmë ekziston forma e prerë e vendimit. Kjo ishte një tendencë e Kuvendit që të mbajë llogaridhënës gjyqësorin për vendimet që kanë marrë dhe njëkohësisht të rishikojnë këto vendime. Raporti i Progresit për Kosovën ka theksuar se “Vendimi i Kuvendit për të debatuar çështjen e ashtuquajtur Kiqina (në të cilën u gjetën fajtorë për vrasje ish-anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës) dhe një përprjekje për të miratuar një vendim që ndërhyr me procesin gjyqësor ishte një hap prapa për përprjekjet e Kosovës për të ndërtuar institucione të pavarura dhe të forta të qeverisjes demokratike. Kjo është një çështje e serioze.”<sup>37</sup>

Ndërhyrjet në sistemin gjyqësor në emër të shkallshmërisë janë hasur edhe në rastet tjera, sikurse potencon Raporti i Progresit “Sa i përket pavarësisë dhe paanshmërisë, janë raportuar rastet e ndërhyrjes politike në gjyqësor. Kjo përfshin pikat e bëra nga qeveria dhe Kuvendi mbi vendimet në lidhje me krimet e luftës (grupi i Kleçkës dhe Drenicës). Kjo është vërejtur po ashtu edhe nga

<sup>32</sup> Intervistë me z. Behar Selimi, anëtar i Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës. Nëntor 2013.

<sup>33</sup> Intervistë me z. Behar Selimi, anëtar i Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës. Nëntor 2013.

<sup>34</sup> “Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012”. Procesverbal i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion. Legjislatuva IV-të. 16 shtator 2013. Komisioni për Legjislacion. Kuvendi i Republikës së Kosovës.

<sup>35</sup> “Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012”. Procesverbal i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion. Legjislatuva IV-të. 16 shtator 2013. Komisioni për Legjislacion. Kuvendi i Republikës së Kosovës.

<sup>36</sup> “Mungesa e llogaridhënies së EULEX-it krijon imazh të keq për Kosovën”, *Kosova Live 360*, shih <http://ëëë.kosovalive360.com/mungesa-e-llogaridhenies-se-eulex-it-krijon-imazh-te-keq-per-kosoven.html#sthash.9d6bjcAJ.rO1cgScV.dpbs> (qasur për herë të fundit me 11 nëntor 2013).

<sup>37</sup> *Dokument pune i personelit të Komisionit Raporti i Progresit 2013 për Kosovën* (Bruksel: Komisioni Evropian, 16 tetor 2013), f. 7.

Gjykatat Supreme dhe Kushtetuese. Ka pasur edhe një përpjekje nga ana e Kuvendit për të hetuar një rast që kishte kaluar në të gjitha hapat e procedurës gjyqësore (rasti Kiqina). Në shqyrtimin e një çështje penale (që përfshin një kryetar komunal) në janar, Gjykata Kushtetuese, duke marrë përsipër rastin dhe duke e referuar atë rast përsëri në Gjykatën Supreme për rishqyrtim, gabimisht sugjeroi se ajo mund të merr përsipër të veprojë si gjykatë (shitesë) e shkallës së fundit.”<sup>38</sup>

Sa i përket KPK-së, Kushtetuta ka konflikt të dispozitave që rregullojnë çështjen e emërimit të të anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Në njëërën anë, te kompetencat e Kuvendit të Republikës, thuhet se Kuvendi “zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë”, ndërsa më vonë thuhet se “përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj”<sup>39</sup>. Në fakt asnjë anëtarë i KPK-së nuk zgjedhet nga Kuvendi, por në këtë Këshill, shërben ex-officio vetëm ministri i Drejtësisë.

### c. Gjyqësori vs. Qeveria

Llogaridhënia e pushtetit gjyqësor dhe prokurorial në raport me pushtetin ekzekutiv më shumë ndërlidhet me aspektin buxhetor. Derisa në raport me KGJK-në, Qeveria nuk ka asnjë përfaqësim dhe kompetencë, në raport me KPK ka një lidhje të drejtpërdrejtë për shkak të pozitës së ministrit të Drejtësisë në KPK, i cili është anëtar ex-officio.

Pavarësisht interpretimeve, çështja e buxhetit, para se të shihet si mjet përmes të cilit sistemi gjyqësor dhe prokurorial jep llogari, duhet të shihet si një mjet përmes të cilit duhet të sigurohet pavarësia më e madhe e gjyqësorit dhe prokurorisë. Nuk mund të pretendohet në logjikë të shëndoshë të varësisë institucionale, në rast që buxheti kualifikohet si një mekanizëm përmes të cilit duhet të kushtëzohet llogaridhënia, më përpara pavarësia buxhetore e sistemit gjyqësor dhe prokurorial duhet të shihet si mekanizëm që kushtëzon pavarësinë sesa llogaridhënien ndaj pushteteve të tjera, kjo është më e evidente, kur kemi parasysh edhe ndërlidhjen e buxhetit, me qeverinë si bartëse e drejtpërdrejtë e pushtetit ekzekutiv.<sup>40</sup> Buxheti mund të llogaritet një prej formave të llogaridhënies, por nuk mjafton, sepse pushtetet tjera nuk guxojnë të rrezikojnë të vendosin kontrollin vetëm përmes buxhetit, sepse zvogëlimi i buxhetit mund të rrisë mundësinë për korrupsion në përmasa tjera nga ato për të cilat dyshohet, flitet apo për të cilat ka perceptim.<sup>41</sup> Prandaj, kufizimet buxhetore gjithsesi se prekin më shumë pavarësinë e sistemit

<sup>38</sup> Dokument pune i personelit të Komisionit Raporti i Progresit 2013 për Kosovën (Bruksel: Komisioni Evropian, 16 tetor 2013), f. 11.

<sup>39</sup> Neni 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës]. Kapitulli i VII-të. Sistemi i Drejtësisë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008.

<sup>40</sup> Intervistë me z. Florent Muqaj, Drejtor Ekzekutiv në Institutin për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare. Nëntor 2013.

<sup>41</sup> Intervistë me z. Behar Selimi, anëtar i Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës. Nëntor 2013.

gjyqësor dhe prokurorial sesa që kontribuon në aspektin e llogaridhënies.<sup>42</sup> Madje, që buxheti të mos jetë problematik nga viti në vit, për të krijuar një siguri se për çdo vit buxheti nuk guxon të preket dhe të jetë më i vogël sesa viti paraprak është vendosur që kjo çështje të futet si kategori e garantuar me Kushtetutë.<sup>43</sup>

---

<sup>42</sup> Intervistë me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, njëherësh Kryetar i KPK-së. Nëntor 2013.

<sup>43</sup> Intervistë me z. Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë, njëherësh anëtar ex-officio në KPK.

## IV. LLOGARIDHËNIA E BRENDSHME E GJYQËSORIT

Prej të gjitha mënyrave të llogaridhënies ndaj pushteteve tjera, Kushtetuta dhe ligjet përcjellëse kanë synuar që llogaridhënia e gjyqësorit dhe prokurorive të burojë prej brenda nga mekanizmat e kontrollit të vetë gjyqësorit. Si KGJK ashtu edhe KPK kanë dy mënyra përmes të cilave sigurojnë llogaridhënien e brendshme. E para përmes rezultateve të performancës, të cilat sigurohen përmes realizimit të normave në aspektin kuantitativ dhe vlerësimit të punës në aspektin kualitativ. Dhe së dyti për hetimit të sjelljeve disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve dhe poashtu anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së, të cilat hetime janë nën mandat të Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

Ekziston një fije e hollë e dallimit në mes të asaj se çfarë përbën llogaridhënie dhe çfarë përbën ndërhyrje në punën e gjykatësve apo prokurorëve. Duke marrë parasysh pavarësinë që gëzojnë gjykatësit në vendimmarrje, llogaridhënia është një aspekt mjaftë i ndjeshëm. Njëkohësisht, llogaridhënia patjetër se vetëm sa e forcon pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatësve dhe prokurorëve. Andaj pavarësia për gjykatës dhe prokurorë nuk duhet të interpretohet si një e drejtë absolute, por, ajo shkon dorë për dorë me llogaridhënien. Pa këtë të dytën, pavarësia e pakufizuar do i veshte personat në pozita të gjyqararit me fuqi absolute duke shtuar gjasat edhe për abuzim me gjithë atë fuqi.

Kemi dy aspekte të llogaridhënies, aspektin e etikës apo disiplinimit si dhe aspektin e performancës. Njëri është kryesisht vlerësim për një akt të vetëm ndërsa tjetra ka të bëjë me vlerësim të veprimeve të gjykatësve për periudha më të gjata kohore.

### a. Shkallshmëria e sistemit

Iniciativat e tanishme për reformë në sistemin e drejtësisë kanë përfshirë gjithashtu reformën strukturore të gjyqësorit. Sistemi i kaluar është përbërë nga Gjykatat Komunale, Gjykatat e Qarkut dhe Gjykata Supreme, me kompetenca mjaftë të përziera. Kjo strukturë ndërlidhej më shumë me sistemin shtetërorë gjatë komunizmit, nuk mundësonte specializim të gjyqarëve, dhe paraqiste problem për shkak të kompetencave mjaftë të ndërlikuara.

Sistemi i tanishëm i drejtësisë në Kosovë përbëhet nga tri nivele të gjykatave të rregullta, Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Rrjedhimisht palët në rastet gjyqësore kanë mundësi të ankohen rreth vendimeve gjyqësore qoftë sa i përket vendimit apo aspektit procedural. Në raste të veçanta, palët mund të adresojnë ankesë ndaj një gjykate të rregullt edhe në Gjykatën Kushtetuese për të ushtruar funksionin e kontrollit kushtetues.<sup>44</sup> Shkallshmëria e tillë bën që të kemi siguri më të madhe juridike, të funksionimit të drejtësisë,

<sup>44</sup> Hasani E., Cukalovic I., *Komentar Kushtetuta e Republikës së Kosovës* (Prishtinë: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH, dhjetor 2013), f. 568.

përmes përmirësimit të lëshimeve të bëra nga nivelet më të ultë si dhe të evitohet marrja e vendimeve arbitrare.

## **b. Kodet e Etikës dhe të Sjelljes**

Ekzistojnë një numër i kodeve të etikës dhe sjelljes për anëtarët e mekanizmave që udhëheqin sistemin gjyqësor dhe prokurorial si dhe për gjyqtarët dhe prokurorët, ku përfshihen:

- Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë (25 prill 2006, amandamenti i fundit me 5 shtator 2006)
- Kodi i Etikës për Sjelljen Profesionale për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (8 tetor 2012)
- Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për gjyqtarët porotë (25 prill 2006, amandamenti i fundit me 5 shtator 2006)
- Kodi i Mirësjelljes për personelin e administratës gjyqësore
- Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë (31 korrik 2012)
- Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës (31 korrik 2012)
- Kodi i Etikës profesionale për punonjësit mbështetës (31 korrik 2012)

Çështja e disiplinimit të gjykatësve është e rregulluar sipas “Kodit të etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtarë”, i cili është miratuar më 25 prill 2006. Këshilli Prokurorial i Kosovës ka nxjerrë Kod të veçantë të etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorët në vitin 2012. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2013, thekson se të dy Këshillat kanë nevojë të rregullojnë rregulloret disiplinore ashtu që “procedurat disiplinore dhe politikat për luftimin e korrupsionit në gjyqësor të qojnë drejt rezultateve konkrete.”<sup>45</sup> Kodet e mirësjelljes nuk specifikojnë të gjitha veprimet deri në detajin e fundit, mirëpo japin një bazë të mirë për të interpretuar se çfarë përbën sjellje të pahijshme apo shkelje të parimeve.

Këshilli Prokurorial dhe ai Gjyqësor kanë mungesë të një mekanizmi i cili do të nxirrte opinione apo do të bënte interpretim të çështjeve të ndryshme të Kodit. Në mungesë të një mekanizmi të tillë, rëndësia e Kodeve nuk është ngritur në nivelin e duhur. Për më tepër, gjyqtarët dhe prokurorët bëjnë interpretime nga më të ndryshmet sa i përket çështjeve të caktuara. Gjyqtarët dhe prokurorët nuk kanë mundësi t’i adresohen një trupi të pavarur këshilldhënës të ndarë nga Komisioni Disiplinor për të shqyrtuar nëse aktivitetet të caktuara jashtë gjykatës dhe prokurorisë përbëjnë sjellje jo profesionale apo shkelje të kodit të etikës.

## **c. Angazhimi jashtë-gjyqësor i gjykatësve dhe prokurorëve**

---

<sup>45</sup> Raporti i Progresit 2013 për Kosovën (Bruksel: Komisioni Evropian, 16 tetor 2013), f. 11.

Gjyqtarët dhe prokurorët punë dhe fokus primar kanë punën e tyre në funksionin gjyqësor dhe prokurorial. Të gjitha angazhimet tjera jashtë-gjyqësore/prokuroriale të gjyqtarëve dhe prokurorëve paraqesin një formë për të mbajtur kontakt me shoqërinë dhe realitetin duke mos u izoluar.<sup>46</sup> Çdo angazhim jashtë-gjyqësor/prokurorial i gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të peshohet se si vlerësohet një angazhim i tillë nga publiku, me fokus në atë se si vlerësohet nga vëzhgues që janë mirë të informuar për sistemin.<sup>47</sup>

Në Kosovë, zyrtarët qeveritarë dhe zyrtarët e institucioneve tjera shtetërore kryesisht për shkak se mbajnë pozita me ndikim të madh në shoqëri, kanë përfituar edhe poste të shumta jashtë institucioneve ku punojnë. Një fenomen i tillë gjithsesi është paraqitur edhe tek personat që janë emëruar gjyqtarë dhe prokurorë. Gjyqtarët dhe prokurorët janë ndër shërbyesit më të privilegjuar të institucioneve shtetërore, duke marrë parasysh pavarësinë e garantuar, mandatin e tyre të përhershëm, si dhe pagën dinjitoze. Megjithatë, një status i tillë duket se nuk iu mjafton dhe tanimë kanë shfaqur pa hezitim apetit për pozita jashtë-gjyqësorit të cilat iu konsumojnë kohë dhe vëmendje të konsiderueshme kundrejt shpërblimit material. Të gjitha këto veprime bëhen në kuadër të ligjit por gjithsesi ka hapësirë të interpretohen edhe si shkelje të Kodit të Etikës apo Sjelljes. Në mesin e këtyre gjykatësve dhe prokurorëve ka edhe të atillë që ushtrojnë deri në nëntë funksione të ndryshme, ku përveç detyrës së gjyqtarit angazhohen edhe në punë analitike, mësimdhënie, si dhe angazhime tjera, të gjitha këto shpërblehen me të ardhura.

Bazuar në komentare të Kodeve të Etikës së Gjyqtarëve, gjykatësit nuk duhet të krijojnë përshtypjen se janë duke përdorur pozitat e tyre për avancimin e interesave personale. “Gjyqtari gjithashtu nuk duhet të kalojë kohë të konsiderueshme larg detyrave të tij/saj si gjyqtar për të mbajtur ligjerata ose aktivitete tjera me kompensim. Përveç kësaj, burimi i pagesës nuk duhet të ngre ndonjë pyetje të ndikimit të panevojshëm ose lidhur me aftësinë e gjyqtarit për të qenë i paanshëm në ndonjë rast të ardhshëm që mund të paraqitet para gjykatës.”<sup>48</sup> Kjo ndodh vazhdimisht në Kosovë, sidomos kur kihet parasysh fakti i përmendur më lartë, se ka gjykatës që mbajnë disa pozita që kërkojnë angazhim të madh, sidomos të tillët që mbajnë nga nëntë pozita.

<sup>46</sup> Opinioni i Këshillit Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian thekson se duhet të ketë një balancë në mes të asaj sa përfshihen në shoqëri gjyqtarët dhe nevojës për t’u parë si të pavarur dhe paanshëm në veprimet e tyre. Opinioni numër 3 i Këshillit Konsultativ për Gjyqtarët Evropian (KKGJE) për vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që qeverisin sjelljen profesionale të gjykatësve, në veçanti etika, sjelljet dhe paanshmëria që nuk është në pajtim.

<sup>47</sup> Ky opinion i KKGJE-së thekson se konteksti shoqëror është mjaftë i rëndësishëm në përcaktim se cilat aktivitetet jashtë-gjyqësore mund të mos jenë të përshtatshme. Në Kosovë, fusha e arsimit shihet si një fushë ku njerëzit më shumë përfshihen për të përfituar materialisht si dhe për të krijuar autoritet përmes mbajtjes së një pozite sesa një angazhim i pastër për të mirën e shkencës, komunitetit të caktuar, si dhe publikut të gjerë. Opinioni numër 3 i Këshillit Konsultativ për Gjyqtarët Evropian (KKGJE) për vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që qeverisin sjelljen profesionale të gjykatësve, në veçanti etika, sjelljet dhe paanshmëria që nuk është në pajtim.

<sup>48</sup> Koment 4.2.54. Pranimi i honorareve të arsyeshme. “Një gjyqtar nuk është i ndaluar nga pranimi i honorareve apo pagesave për ligjerata me kusht që kompensimi është i arsyeshëm dhe proporcional me detyrën e kryer. Megjithatë, gjyqtari duhet të sigurojë që të mos krijohen konflikte gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve. Gjyqtari nuk duhet të krijojë përshtypjen se është duke përdorur pozitën e tij/saj të gjyqtarit për avancimin e interesave personale. Gjyqtari gjithashtu nuk duhet të kalojë kohë të konsiderueshme larg detyrave të tij/saj si gjyqtar për të mbajtur ligjerata ose aktivitete tjera me kompensim. Përveç kësaj, burimi i pagesës nuk duhet të ngre ndonjë pyetje të ndikimit të panevojshëm ose lidhur me aftësinë e gjyqtarit për të qenë i paanshëm në ndonjë rast të ardhshëm që mund të paraqitet para gjykatës”.



Ligji për Gjykata përcakton qartë dispozita, të cilat medoemos duhet të bëjnë të kujdesshëm secilin gjykatës në ushtrimin e çfarëdo veprimtarie, e cila mund të perceptohet si ndërhyrje në pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Dispozita rreth ndalesave mbi sjelljen e gjykatësve, thekson se “gjykatësit nuk kryejnë asnjë detyrë apo shërbim që mundet apo mund të perceptohet si ndërhyrje me pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre apo që përndryshe nuk është në përputhje me detyrat e një gjyqtari apo dispozite të Kodit të Mirësjelljes për Gjyqtarë”.<sup>49</sup> Pjesa e parë e kësaj dispozite, në kontekstin e Kosovës dhe ushtrimit të veprimtarive jashtë-gjyqësore të gjykatësve, përkatësisht angazhimi i tyre në ligjërime, ka krijuar perceptimin se gjykatësit nuk janë të pavarur dhe të paanshëm në punën e tyre, për shkak të interesave për avancim dhe përfitime financiare të tyre.<sup>50</sup>

Sipas komentarëve të Kodeve të Etikës së Gjykatësve, shtrohet nevoja që gjykatësit të pranojnë kufizime rreth aktiviteteve të tyre. Për shkak të rëndësisë së madhe, si bartës të funksioneve gjyqësore, prej të cilit varet ndarja e drejtësisë, gjykatësit duhet të pranojnë kufizime në aktivitetet e tyre sepse ata pritet që të jenë vazhdimisht subjekt i vëzhgimeve dhe komenteve të publikut. Madje, “ligjshmëria e sjelljes së gjyqtari, edhe pse është relevante, nuk është faktori i vetëm për përcaktimin e rregullsisë”.<sup>51</sup> Në Kosovë vitet e fundit ka pasur një evazion të institucioneve të arsimit të lartë, në të cilat është angazhuar një numër i gjykatësve dhe prokurorëve si ligjërues në Fakultetet Juridike. Angazhimi i tyre në aktivitete shkencore dhe të ligjërimit nuk ndalohet me kornizën ligjore. Megjithatë, ky angazhim ka krijuar perceptim të tillë, i cili është ngritur në opinion publik se angazhimi i tyre nuk bëhet për shkak të ekspertizës së tyre, por për shkak të pozitave dhe mundësisë që përmes tyre të ndikohen prokurorët dhe gjykatësit që të mos ndjekin apo mos gjykojnë ata (bartësit e arsimit të lartë privat) në rast të shkeljeve ligjore.<sup>52</sup> Gjykatësit mund të angazhohen në aktivitete jashtë-gjyqësore, përfshi ligjërimit, “megjithatë, duhet të gjendet një ekuilibër i mirë mes nevojës për përfshirje në aktivitete jashtë-gjyqësore dhe nevojës për të mos krijuar përshtypjen se këto aktivitete mund të ndikojnë në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarit. Është e rëndësishme që të shtrohet pyetja nëse në kontekstin përkatës social dhe në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm, gjyqtari është angazhuar në aktivitete të cilat objektivisht mund të komprometojnë pavarësinë ose paanshmërinë e tij/saj ose të krijojë këtë përshtypje”.<sup>53</sup> Përshtypja se një gjë e tillë po ndodh me gjykatësit në Kosovë tashmë është krijuar te një pjesë e opinionit publik, në të cilin janë hapur debate publike.

<sup>49</sup> Neni 35, Ndalesat mbi Sjelljen e Gjyqtarëve. Ligji për Gjykatat.

<sup>50</sup> “Gjysma e prokurorëve dhe gjykatësve kanë nga dy vende pune”. Portali Express. 4 dhjetor 2013. (<http://ëëë.gazetaexpress.com/?cid=1,15,128183>)

<sup>51</sup> Koment: 4.2.2. Gjyqtari duhet të pranojë kufizimin e aktiviteteve të tij/saj. “Gjyqtari duhet të presë që të jetë subjekt i vëzhgimit dhe komenteve të vazhdueshme nga publiku dhe për këtë arsye duhet të pranojë kufizimet mbi aktivitetet e tij ose të saj - madje edhe aktivitetet që nuk do të hasnin në kundërshtime nëse zhvillohen nga pjesëtarët e tjerë të komunitetit apo edhe të profesionit. Kjo vlen si për sjelljen profesionale ashtu edhe për atë personale të gjyqtarit. Ligjshmëria e sjelljes së gjyqtari, edhe pse është relevante, nuk është faktori i vetëm për përcaktimin e rregullsisë”.

<sup>52</sup> IKD intervistë me z. Hasan Preteni. Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit.

<sup>53</sup> Koment: 4.2.41. Pjesëmarrja në aktivitete jashtë-gjyqësore.

Institucionet private të arsimit të lartë kanë angazhuar gjykatës në rolin e ligjëruesve në lëmin e drejtësisë. Këto institucione të arsimit janë të regjistruara si biznese për fitim. Ky angazhim nga KGJK dhe gjykatësit shihet si diçka brenda suazave ligjore ndërsa nga agjencia që ka mandat parandalimin e konfliktit të interesit si diçka e dëmshme për efikasitetin e pushtetit gjyqësor.<sup>54</sup> Angazhimi në mësimdhënie është një punë mjaftë sfiduese dhe kërkon vëmendje të madhe për ligjëruesit. Rreziku i madh i angazhimit të gjyqtarëve në punë jashtë gjyqësorit është në rastet kur gjyqtarët angazhon në aktivitete për të cilat marrin shpërblim dhe kërkohet vëmendje më e madhe.<sup>55</sup>

Në anën tjetër, Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, zyrë kjo që heton prokurorët dhe gjyqtarët për sjellje të pahijshme dhe shkelje të Kodit të Etikës, e ka të ndaluar me ligj që të pranojë ndonjë kompensim shtesë përveç shpenzimeve të arsyeshme dhe të nevojshme.<sup>56</sup> Kjo është një nga mënyrat për parandalim të ndonjë konflikti të interesit.

Gjyqtarët dhe prokurorët përveç detyrave të tyre për të hetuar, ndjekur dhe gjykuar raste të ndryshme, kanë për detyrë edhe të marrin pjesë në komisione dhe funksione tjera ndryshe prej funksioneve bazë. Për shembull, në bazë të ligjit, gjyqtarët dhe prokurorët janë të caktuar të marrin pjesë në Panelin për Lirim me Kusht,<sup>57</sup> në Komisionet përkatëse për Vlerësimin e Performancës si dhe komisione tjera, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës,<sup>58</sup> në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,<sup>59</sup> si dhe organe tjera. Në të gjitha këto angazhime, gjyqtarët dhe prokurorët pranojnë detyra dhe të ardhura të cilat kërkojnë vëmendje dhe përkushtim që mund të reflektohet në vështirësi të theksuara për zbatimin e funksioneve gjyqësore dhe prokurorial. Për disa nga këto angazhime, gjyqtarët kompensohen me të ardhura më të madhe se 25% e pagës së tyre të rregullt mujore të gjyqtarit.<sup>60</sup> Këto pozita janë të parapara me ligj, megjithatë, kompensimi për këto pozita bie ndesh me Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarët.

<sup>54</sup> Konushevci A., "Angazhimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në punët e tyre", 4 dhjetor 2013, Radio Evropa e Lirë, shih <http://ëëë.evropaelire.org/content/article/25189866.html> (qasur për herë të fundit me 7 janar 2014).

<sup>55</sup> Opinioni numër 3 i Këshillit Konsultativ për Gjyqtarët Evropian (KKGJE) për vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që qeverisin sjelljen profesionale të gjykatësve, në veçanti etika, sjelljet dhe paanshmëria që nuk është në pajtim.

<sup>56</sup> Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 46, Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

<sup>57</sup> Sipas ligjit, një gjyqtarë dhe një prokurorë janë pjesë e Panelit për Lirim me Kusht. Neni 122, Paneli për lirim me kusht, Ligji numër 04/L-149 për Ekzekutimin e sanksioneve penale, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 28 gusht 2013.

<sup>58</sup> Pesë anëtarët e PZAP-it, gjyqtarë të Gjykatës Supreme dhe të Apelit, emërohen nga Gjykata Supreme. Neni 115, Emërimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, Ligji numër 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.

<sup>59</sup> Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidenti i vendit emëron Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli. Neni 139, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

<sup>60</sup> Për shembull, gjykatësit të cilët angazhohen në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës marrin rreth 4,000-5,000 Euro në vit për këtë angazhim, që është mbi 25% e pagës bazë të tyre mujore. Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë thekson se "[kur përcaktohet nëse gjyqtarit i lejohe të pranojë kompensim për veprimtari jogjyqësore gjatë orarit të punës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të zbatojë kushtetet e barabarta për të gjitha për të gjithë gjyqtarët si në vijim] shuma e kompensimit nuk duhet të tejkalojë 25 përqindëshin nga paga e rregullt mujore e gjyqtarit;". II. Rregullat specifike të etikës, B. Veprimtaritë jogjyqësore, Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarët. Po ashtu, Deklaratat e pasurisë të publikuara në ueb-faqen e Agjencisë Kundër Korrupsion të gjyqtarëve të cilët janë emëruar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.

Disa gjyqtarë kanë të ardhura shumë të mëdha nga përfshirja në funksione tjera jashtë gjyqësorit, të cilat për afërsisht arrijnë pagën bazë të gjyqtarit. Këtu kemi një shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Gjyqtarit, pasi që ky Kod nuk lejon që shumica e kompensimit të tejkalojë 25 përqindëshin nga paga e rregullt mujore e gjyqtarit.<sup>61</sup> Bizneset të cilat angazhojnë gjyqtarë dhe prokurorë tanimë kanë raste në prokurori dhe lëndë të cilat janë duke u shqyrtuar nëpër gjykata.<sup>62</sup> Këto raste do të jenë një sfidë për sistemin e drejtësisë, duke pasur parasysh interesat e ngushta të disa prokurorëve dhe gjyqtarëve nga palët e tilla.

#### d. Paraqitja e pasurisë dhe të ardhurave

Gjyqtarët dhe prokurorët janë të obliguar që të deklarojnë pasurinë e tyre dhe këta formularë publikohen edhe në faqen zyrtare të Agjencisë Kundër Korrupsionit.<sup>63</sup> Informatat rreth pasurisë dhe të ardhurave freskohen çdo vit dhe janë të qasshme për publikun në çdo moment. Një mundësi e tillë kontribuon shumë në transparencën e sistemit dhe se publiku lehtë mund të vlerësojë nëse gjyqtarë apo prokurorë të caktuar kanë interesa të caktuar apo kanë vënë në lajthitje organet shtetërore sa i përket pasurisë dhe interesave. Një pjesë e madhe e të dhënave të paraqitura nga gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë lehtë të krahasueshme dhe nuk janë të plota.<sup>64</sup> Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal, nga data 1 janar 2013, mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare përbën veprë penale, që më parë kishte paraqitur vetëm kundërvajtje.<sup>65</sup> Dënimet për këtë veprë penale janë tejet të ashpra, duke përfshirë dënim kumulativ me gjobë dhe burg, si dhe konfiskim i vlerës së padeklaruar të pasurisë.

Pas deklarimeve të pasurisë për vitin 2012, Agjencia Kundër Korrupsionit ka bërë kontrollin e plotë të formularëve të 59 zyrtarëve nga gjithsejtë 270 sa kanë dorëzuar formularët në fushën e

<sup>61</sup> Seksioni B, Veprimtaritë jogjyqësore, pjesa 3.b., *Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë*.

<sup>62</sup> Një nga pronarët e një kolegji universitar është i akuzuar së bashku me tre bashkëpunëtorë për përfitim të kundërligjshëm të pronës së paluajtshme. Në këtë kolegji universitar janë të angazhuar gjyqtarë dhe prokurorë të sistemit në rolin e mësimeve, gjë që . *Bajrami S.*, "Aktakuzë për pronarin e kolegjit", *Zeri.info*, 21 janar 2014, shih <http://ëëë.zeri.info/artikulli/25223/aktakuze-per-pronarin-e-kolegjit-fama>.

<sup>63</sup> Ligji ka përkufizuar se Zyrtar të Lartë janë edhe gjyqtarët, prokurorët, anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Këta Zyrtarë të Lartë së bashku me anëtarët e familjeve të tyre duhet të paraqesin pasurinë e tyre dhe të ardhurat. Ligji nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 31 gusht 2011.

<sup>64</sup> *Shënim:* Në disa raste, gjyqtarët dhe prokurorët nuk kanë deklaruar të ardhurat dhe pozitat nga të cilat përfitojnë të mira materiale, sikurse përfshirja në komisione të ndryshme, duke i bërë kështu të dhënat e paraqitura në formularë të mos jenë reale. Për disa pozita, ata kanë deklaruar të ardhurat mujore, ndërsa për disa pozita tjera të ardhurat vjetore, gjë që e bënë mjaftë të ndërlikuar krahasimin e këtyre të të dhënave.

<sup>65</sup> Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal, këto veprime janë shndërruar në vepra penale dhe hyjnë në Kapitullin XXXIV Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Neni 437, Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare, Kodi Penal, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 prill 2012, ka hyrë në fuqi 1 janar 2013.

gjqësorit.<sup>66</sup> 13 nga këta formularë janë ndryshuar pas kontrollit të plotë. Edhe pas këtij kontrolli të plotë, deklarimi i pasurisë dhe të ardhurave të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka shumë mangësi, të cilat janë reflektuar edhe në deklaratimet e vitit 2013.

## e. Zyra e Prokurorit Disiplinor

Zyra e Prokurorit Disiplinor<sup>67</sup> (ZPD) është institucioni i pavarur i thirrur për të hetuar shkeljet e mundshme të pahijshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve. ZPD pas grumbullimit të materialeve dhe provave vendos nëse rasti duhet të paraqitet para Komisionit Disiplinor të KGJK-së apo KPK-së, ose të hedhë rastin.

### Kutia 1:

Shkeljet disiplinore që hetohen nga ZPD përfshijnë:<sup>68</sup>

- a). Kryerja e veprës penale apo të kundërvajtjes që nuk është në përputhje me obligimin e gjyqtarit për ruajtjen e standardit të lartë të ndershmërisë morale dhe etike,
- b). Shpërfillje e funksionit gjyqësor,
- c). Sjellje që nuk është në përputhje me obligimin e gjyqtarit që të jetë i pavarur dhe i paanshëm,
- d). Çfarëdo shkelje të kodit relevant të etikës dhe sjelljes,
- e). Mosveprimi në pajtim me vendimet dhe urdhrat e nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
- f). Dhënia e informacioneve të rrejshme, mashtruese apo jo të plota për çfarëdo çështje në kompetencën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës duke përfshirë edhe dhënien e këtyre të dhënave në kërkesën për emërim si gjyqtar apo gjyqtar porotë gjatë kohës së kërkimit të avancimit në pozitë apo në kontekst të çështjeve disiplinore.

Zyra e Prokurorit Disiplinor ka mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe financiare. Kryesuesi i KGJK-së ka deklaruar se “Në përbërjen e kësaj zyre unë nuk jam i kënaqur ngase nuk ka kapacitete të mjaftueshme edhe profesionale por edhe ndoshta edhe logjistike dhe të gjitha ato që mundet në mënyrë të drejtë dhe të qartë me hetu një rast të sjelljes së pahijshme të gjykatësve.”<sup>69</sup> ZPD kishte ngritur shqetësim për shkak se Instituti Gjyqësor i Kosovës nuk kishte ftuar

<sup>66</sup> *Shënim:* Sa i përket prokurorëve është e vështirë të kemi informata se sa nga formularët e zyrtarëve të sistemit prokurorial janë kontrolluar, pasi që formularët e prokurorëve dhe zyrtarëve tjerë të sistemit nuk janë ndarë në kategori të vecantë por janë përfshirë në kategorinë e institucioneve të pavarura. *Raport vjetor janar-dhjetor 2012* (Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsion, mars 2013), f. 22.

<sup>67</sup> ZPD, fillimisht ka qenë e njohur si Njësia e Inspektimit Gjyqësor, organ ky pranë Departamentit të Drejtësisë. Me 14 qershor 2008, Njësia e Inspektimit Gjyqësor është transformuar në ZPD.

<sup>68</sup> Neni 5.3 të UA nr. 2006/8 (e zbatueshme sipas nenit 11 të LPPKGJK) përcakton shkeljet disiplinore.

<sup>69</sup> IKD intervistë me z. Enver Peci, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

personelin e ZPD-së në trajnime.<sup>70</sup> Në këtë kohë, ZPD ka pesë inspektor të cilët mbulojnë 350 gjykatës dhe 124 prokurorë. Ky është një numër tejet i vogël i inspektorëve për të mbuluar një numër kaq të madh të gjykatësve dhe prokurorëve duke pasur parasysh vonesat e mëdha të organeve të drejtësisë në zgjidhjen e lëndëve gjyqësore. Pavarësia institucionale e ZPD-së është mjaftë e brishtë. Mungesa e pavarësisë ndikohet nga tri aspekte emërimi i drejtorit, menaxhimi dhe buxheti.<sup>71</sup> Ky kufizim i pavarësisë së ZPD-së sigurisht se ka edhe pasoja në efikasitetin dhe kualitetin e punës të këtij mekanizmi.

<b>Masat e shqiptuara</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>
<i>Raporte të dorëzuara nga ZPD</i>	62	12	19
<i>Seanca të mbajtura nga Komisioni Disiplinor</i>	12	?	11
Ndërprerje e procedurës për shkak se kanë përfunduar mandatin gi gjykatës	17	0	0
Pushim i procedurës për shkak të vdekjes së gjykatësve	2	0	0
Qortim	17	5	7
Ulje e pagës për 50 % për dy muaj	1	2	2
Ulje e pagës për 50 % për katër muaj	0	1	0
Qortim dhe Vërejtje	1	0	0
Lirim nga përgjegjësia disiplinore	14	7	11
Refuzim i kërkesës së ZPD për suspendim	1	0	0
Lirim nga përgjegjësia disiplinore për shkak se kanë pushuar funksionin si gjykatës edhe pse Komisioni Disiplinor ka konstatuar sjelljet e pahijshme të gjykatësve	4	0	0
Qortim me Udhëzim për ndërmarrjen e veprimeve Korrigjuese	0	7	1
Suspendim nga pozita e gjyqtarit përkohësisht	0	3	2
Komisioni Disiplinor i ka rekomanduar KGJK-së që t'i propozoj Presidentit për shkarkim	0	2	23
<b>Numri i përgjithshëm i masave të shqiptuara</b>	<b>57</b>	<b>27</b>	<b>23</b>
<i>Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor</i>	11	8	14
<i>Pranimi i ankesave si të bazuara dhe kthimi i rasteve në Komision Disiplinor</i>	1	0	0

Tabela 1 - Vendimet disiplinore në KGJK

<b>Masat e shqiptuara</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>
<i>Raporte të dorëzuara nga ZPD</i>	16	15	4
<i>Seanca të mbajtura nga Komisioni Disiplinor</i>	?	?	?

<sup>70</sup> Nga data 18 shtator 2008 deri më 18 qershor 2010, ZPD nuk ka pranuar asnjë ftesë nga IGJK që profesionistë apo zyrtarë ligjor të ZPD-së të marrin pjesë në trajnimet, seminarët apo aktivitetet tjera të organizuara nga IGJK. Raporti punës i ZPD 2010 (Prishtinë: Zyra e Prokurorit Disiplinor, shkurt 2011), f. 47.

<sup>71</sup> Drejtori i ZPD-së më së shumti e sheh problematike çështjen e buxhetimit ku thekson se ka konflikt në mes të Ligjit për KGJK-në dhe Ligjit për KPK-në, të cilat kanë hyrë për një ditë në fuqi. IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

Pezullim	6	3	0
Qortim	1	2	1
Ulje e pagës për 50 % për tre muaj	0	1	1
Ulje e pagës për 50 % për gjashtë muaj	1	1	0
Qortim Korrigjues	0	1	0
Nuk është sanksionuar	0	0	1
Lirim nga përgjegjësia disiplinore për shkak se kanë pushuar funksionin si gjykatës edhe pse Komisioni Disiplinor ka konstatuar sjelljet e pahijshme të gjykatësve	0	0	0
Hedhje e raportit	1	1	0
Qortim me Urdhër për ndërmarrjen e veprimeve Korrigjuese	0	0	1
Suspendim nga pozita e prokurorit për kohësisht	0	0	0
Suspendim pa pagesë	1	2	0
Komisioni Disiplinor i ka rekomanduar KPK-së që t'i propozoj Presidentit për shkarkim	0	0	0
<b>Numri i përgjithshëm i masave të shqiptuara</b>	<b>10</b>	<b>11</b>	<b>4</b>
<i>Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor</i>	1	8	0
<i>Pranimi i ankesave si të bazuara dhe kthimi i rasteve në Komision Disiplinor</i>	0	2	0

Tabela 2 - Vendimet disiplinore në KPK

### *i. Emërimi i drejtorit*

Drejtori i ZPD-së zgjedhet nga 2/3 e anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së.<sup>72</sup> Kjo mënyrë e zgjedhjes së drejtorit si dhe përgjegjësitë e mëdha të KGJK-së dhe KPK-së në menaxhimin e ZPD-së krijojnë hapsirë për cenim të pavarësisë së gjyqësorit. Sipas Ministrit të Drejtësisë, ekzistojnë dy mundësi të krijimit të kontrollit dhe balancit për sistemin e drejtësisë, qoftë në procesin e emërimit apo procesin e disiplinimit të gjykatësve dhe prokurorëve. Pasi që cdo ndërhyrje në emërim cilësohet si ndërhyrje e rëndë në pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, mbetet që të rregullohet më mirë procesi i disiplinimit.<sup>73</sup> Përzgjedhja e tanishme e drejtorit assesi nuk mund të siguroj pavarësinë institucionale të ZPD-së.

Për të siguruar pavarësi më të madhe të këtij mekanizmi, patjetër se duhet siguruar pavarësi më të madhe nga KGJK dhe KPK. Një nga opsionet më të mundshme është themelimi i agjencisë si organ i pavarur, me përgjegjësi ceremoniale ndaj Kuvendit të Kosovës, përveç në çështjen e përzgjedhjes së Drejtorit të ZPD-së.

### *ii. Buxhetimi*

<sup>72</sup> Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Neni 46, Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

<sup>73</sup> IKD intervistë me z. Hajredin Kuci, Zv. Kryeministër dhe Ministër i Drejtësisë.

Një nga problemet më të mëdha me institucionet e drejtësisë dhe ato të cilat ndërlidhen me këtë sektor është mungesa e pavarësisë financiare. Një pavarësi e tillë i mungon edhe ZPD-së, dhe kjo më së shumti për fajin e konfliktit në mes të Ligjit për KGJK-në dhe Ligjit për KPK-në. Në Ligjin për KGJK-në, pavarësia financiare është siguruar deri në nivel shumë të lartë ku kërkohet që ZPD të dërgoj buxhetin drejtpërdrejt në Kuvend.<sup>74</sup> Ndërsa, Ligji për KPK-në ka kufizuar këtë kompetencë duke e cunguar edhe pavarësinë financiare të ZPD-së duke kërkuar që projektbuxheti për buxhet të dërgohet në Ministrinë e Financave.<sup>75</sup> Të dyja këto ligje janë aprovuar në ditën e njëjtë dhe tani zbatohet dispozitat e Ligjit për KPK-në. Edhe Drejtori i ZPD-së vlerëson se kjo mënyrë e buxhetimit nuk ka siguruar pavarësinë.<sup>76</sup> Pavarësia e tillë sigurisht se pasqyrohet edhe në mungesë të resurseve adekuate njerëzore dhe logjistike për të përmbushur misionin e kësaj zyre.

## f. Komisionet disiplinore

Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre anëtarë të KGJK-së, dy nga të cilët duhet të jenë gjykatës.<sup>77</sup> Sipas raportit të KGJK-së për vitin 2013, Komisioni Disiplinor i KGJK-së ka shqyrtuar 34 raporte, duke mbajtur 13 seanca disiplinore, duke marrë 27 vendime.<sup>78</sup> Masat e ndërmarra janë qortim (5), qortim me udhëzim për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese (7), ulje e përkohshme e rrogës 50% (3), lirim nga përgjegjësia (7), suspendim i përkohshëm deri në përfundim të hetimit disiplinor (1), suspendim deri në marrje të vendimit nga gjykata (2), dhe propozim për largim nga zyra (2).<sup>79</sup>

Çështja e disiplinimit të gjykatësve është e rregulluar sipas “Kodit të etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtarë”, i cili është miratuar më 25 prill 2006. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2013, thekson se Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale ka nevojë të “përshtatet ashtu që procedurat dhe politikat disiplinore për luftimin e korrupsionit në gjyqësor qojnë drejt rezultateve konkrete.”<sup>80</sup>

Një mori kritikash janë adresuar në vazhdimësi ndaj Komisionit Disiplinor por edhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, shkalla e dytë, rreth vendimeve të tyre për masa disiplinore qoftë për sjellje të pahijshme apo shkelje të kodit të etikës. Raporti i vitit 2010 i ZPD-së ka nxjerrë një mori shqetësimesh kundrejt vendimeve të Komisionit Disiplinor si dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës,

<sup>74</sup> Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 49, Buxheti për zyrën e Prokurorit Disiplinor.

<sup>75</sup> Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 39, Buxheti për zyrën e Prokurorit Disiplinor.

<sup>76</sup> IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

<sup>77</sup> Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Kreu VI – Procedurat Disiplinore, Neni 33 – Komisioni Disiplinor i Këshillit, dekretuar me 18 tetor 2010.

<sup>78</sup> Raporti Vjetor 2012 (Prishtinë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gusht 2013), f. 13.

<sup>79</sup> Raporti Vjetor 2012 (Prishtinë: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gusht 2013), f. 13.

<sup>80</sup> Raporti i Progresit 2013 për Kosovën (Bruksel: Komisioni Evropian, 16 tetor 2013), f. 11.

këto vendime dhe konkluzione të kundërligjshme.<sup>81</sup> Ndër shqetësimet kryesore të ZPD-së është konkluzioni i nxjerrë nga KGJK për parashkrimin e rasteve.<sup>82</sup> Rrjedhimisht, shqetësim kanë qenë edhe vendimet e Komisionit Disiplinor dhe KGJK-së të bazuara në këtë konkluzion.<sup>83</sup> Konkluzioni i tillë nuk ka pasur bazë ligjore dhe ka krijuar hapësirë për subjektivitet të skajshëm dhe arbitraritet në vendosjen e rasteve nga ana e Komisionit Disiplinor dhe KGJK-së. Konkluzioni i tillë i KGJK-së si dhe vendimet e marra duke u thirrur në këtë konkluzion kanë krijuar pasiguri juridike. Njëjtë qëndron situata edhe me disiplinimin e prokurorëve, për të cilët ekziston baza ligjore pothuajse e ngjashme sikurse për gjykatësit, ku shkeljet sanksionohen sipas Kodit të etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë. Sistemi gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë ka mungesë të një trupi, i cili do të bënte interpretime nëse aktivitetet e caktuara përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes. Interpretimet e tilla do të parandalonin shkeljet e mundshme dhe do të shërbenin për të siguruar gjykatësit dhe prokurorët për të hequr dyshimet. Këto interpretime do të vendosnin precedent edhe për të ardhmen si dhe për diskutime të ndryshme që synojnë të përmirësojnë fushën e llogaridhënies. Krijimi i një trupi të tillë madje inkurajohet edhe nga asociacione profesionale ndërkombëtare, duke përfshirë Këshillin Konsultativ për Gjykatës Evropian.

“Sanksionet disiplinore janë shqiptuar në 14 raste nga Këshilli Gjyqësorë (në vitin 2013) dhe në 11 raste nga Këshilli Prokurorial (në vitin 2012 dhe 2013). Asnjë prej tyre nuk ka rezultuar me shkarkim. Duhet të forcohet kodi i sjelljes së gjyqtarëve. Rregulloret disiplinore në të dy këshillat duhet të rregullohen për të garantuar që procedurat disiplinore dhe politikat në luftën kundër korrupsioni në gjyqësorë të dërgojnë në rezultate konkrete.”<sup>84</sup>

## g. Përbërja e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial

<sup>81</sup> Raporti i punës së ZPD-së për vitin 2010 i publikuar në vitin 2011 ka qenë njëri nga raportet më kritike dhe më objektive sa i përket çështjes së llogaridhënies të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Raporti i punës së ZPD 2010 (Prishtinë: Zyra e Prokurorit Disiplinor, shkurt 2011).

<sup>82</sup> Ky konkluzion është marrë me datën 11 shkurt 2010, kur KGJK kishte pasur përbërjen fillestare me anëtarë Lirije Osmani, Zhivojin Jokanovic, Bilgaip Maznika, Gabriella Vaqjentich dhe Hari Katara. Përmbytja e konkluzionit është kjo: “Të gjitha rastet disiplinore të paraqitura në Komisionin Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë të trajtohen veç e veç duke u bazuar edhe në kalimin e kohës relativisht të gjatë nga dita kur është bërë shkelja. Shqyrtimi i rasteve të bazohet në peshën e shkeljes së bërë por edhe në natyrën e rëndit të kalimit të periudhës së gjatë kohore. Për rastet kur konstatohet shkelja e bërë nga gjyqtari, prokurori apo gjyqtari porotë që është akuzuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor njëkohësisht ka kaluar periudhë e gjatë kohore nga dita kur është bërë shkelja të veprohet në atë mënyrë që të mos shqiptohet masë disiplinore. Koha e kaluar duhet të reflektoj në mënyrë adekuate.” Sipas ZPD-së, KGJK nuk ka mandat për të nxjerrë “konkluzione”, por vetëm vendime dhe se konkluzioni i nxjerrë nuk ka as bazë legale dhe as praktike.

<sup>83</sup> Vendimet e tilla kanë qenë KDGJ 2010/09, KDGJ 2010/10, KGJK nr 14/2010, dhe KDGJ 2010/18. Këto vendime theksojnë se gjyqtarët/et janë liruar nga sanksionet disiplinore për shkak se kanë kaluar vite të caktuara nga shkelja e kryer. Ky arsyetim është tejet i mangët dhe kundër-ligjor për shkak se disa raste janë konsideruar si të “vjetërsuara” pasi që kanë kaluar 6 vite e disa tjera për shkak se kanë kaluar 3 vite nga shkelja e bërë. Vendimet e tilla janë krejtësisht subjektive dhe rrjedhimisht të anshme, pasi që nuk ekziston rregullativë ligjore që parashih vjetërsimin e rasteve.

<sup>84</sup> *Dokument pune i personelit të Komisionit Raporti i Progresit 2013 për Kosovën* (Bruksel: Komisioni Evropian, 16 tetor 2013), f. 11.



Përzgjedhja e anëtarëve të KGJK-së paraqet problem mjaftë të theksuar sa i përket ndërhyrjeve të mundshme nga legjislativi në gjyqësor. Kjo për shkak se shumica e anëtarëve të KGJK-së përgjedhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Komisioni Evropian, në Raportin e Progresit për Kosovën, për vite me radhë ka theksuar se kjo përbërje do të jetë problem për pavarësinë e sistemit.

Përveç çështjes së ndërhyrjes nga legjislativi, përbërja e KPK-së dhe KGJK-së ka edhe mangësi tjera të cilat mund të jenë pengesa për të siguruar llogaridhënien e sistemit. Këtu më së shumti ndërldhet çështja e anëtarëve të cilët janë Kryeprokurorë apo Kryetar të Gjykatave. Rrjedhimisht Kryeprokurorët dhe Kryetarët e Gjykatave mbajnë përgjegjës veten e tyre për menaxhimin e prokurorive dhe gjykatave. Në mënyrë që të sigurohet llogaridhënie më e mirë, duhet të rishqyrtohet në qoftë se anëtarësimi i Kryeprokurorëve apo Kryetarëve të Gjykatave në Këshillat përkatës do i kontribuonte më së miri mbajtjes llogaridhënës të sistemit.

“Sa i përket përgjegjshmërisë, Këshilli Gjyqësorë ka miratuar legjislacionin zbatues mbi organizimin dhe aktivitetet e Këshillit, dhe mbi emërimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve. Një panel për vlerësimin e performancës së gjykatësve ka kryer vlerësimet e para në funksion të vërtetimit të mandateve fillestare të gjykatësve.”<sup>85</sup>

---

<sup>85</sup> *Dokument pune i personelit të Komisionit Raporti i Progresit 2013 për Kosovën* (Bruksel: Komisioni Evropian, 16 tetor 2013), f. 11.

## V. REKOMANDIMET:

1. **Këshilli Gjyqësor i Kosovës** duhet të përpiloj Kod të ri të Etikës dhe Sjelljes profesionale. Ky Kod duhet të marrë parasysh standardet dhe dokumentet ndërkombëtarë të cilat synojnë të kontribuojnë drejt respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Po ashtu, ky Kod duhet të marrë parasysh Parimet e Bangalorit për Sjellje në Gjyqësor.
2. **Këshilli Prokurorial i Kosovës** duhet të plotësoj Kodin e Etikës dhe Sjelljes profesionale duke reflektuar në mangësitë të cilat janë hasur me Kodin e tanishëm.
3. **Këshilli Gjyqësor i Kosovës** duhet të krijojë një Komision për Etikë. Ndër tjera një Komision i tillë do të nxirrte opinione sa i përket çështjeve të ndryshme të cilat do të parandalonin shkeljen e kodit nga ana e gjyqtarëve. Po ashtu, këto opinione do të siguronin që të kemi interpretim të aspekteve të ndryshme të Kodit në bazë të kontekstit. Komisioni do të nxirrte opinione sipas kërkesës për sqarim ose sipas vlerësimit të vet.
4. **Këshilli Prokurorial i Kosovës** duhet të krijojë një Komision për Etikë. Ndër tjera një Komision i tillë do të nxirrte opinione sa i përket çështjeve të ndryshme të cilat do të parandalonin shkeljen e kodit nga ana e prokurorëve. Po ashtu, këto opinione do të siguronin që të kemi interpretim të aspekteve të ndryshme të Kodit në bazë të kontekstit. Komisioni do të nxirrte opinione sipas kërkesës për sqarim ose sipas vlerësimit të vet. Opinione të tilla do shtonin rëndësinë e Etikës dhe Sjelljes Profesionale dhe vetëm sa do e kompletinin
5. **Zyra e Prokurorit Disiplinor** duhet të pavarësohet nga KGJK dhe KPK, duke u themeluar si institucion i pavarur. Vetëm në këtë formë mund të sigurohet pavarësi dhe të ngriten kapacitetet e një zyre që duhet të sigurojë se liritë dhe të drejtat e palëve janë garantuar dhe se sjelljet e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë në nivel të cilin kërkohet nga ta. Në këtë frymë, duhet të sigurohet pavarësi financiare për ZPD-në ashtu që mos të jetë peng e kufizimeve të mëdha në resurse që do të ndikonin ndjeshëm në efikasitetin dhe në profesionalizmin e kësaj zyre.
6. **Vlerësimi i performancës** së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të ndërlihet me masa disiplinore. Kriteret për vlerësim të performancës duhet të jenë objektive dhe t'i bëhen të ditura gjyqtarëve dhe prokurorëve kohë më parë, ashtu që të kenë të lehtë të vlerësojnë edhe vetë performancën e tyre.
7. **Përbërja e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Kosovës** duhet të ndryshojë në atë mënyrë që të sigurohet pavarësia si për sistemin gjyqësor ashtu edhe për sistemin prokurorial. Përbërja duhet të reflektojë me numër të anëtarëve që vijnë në KGJK dhe në KPK dhe që nuk janë kryetar gjykatash apo kryeprokuror, në mënyrë që të sigurohet një sistem i mirëfilltë i llogaridhënies për sistemin gjyqësor dhe sistemin prokurorial në Kosovë.